



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Nr.399/1Prot.

Shkodër, më 21.01.2019

**Lënda:** Jepet informacioni i kërkuar

---

**Rruga:** \_\_\_\_\_

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 740, datë 08. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 399, datë 10. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Bashkia e Shkodrës, për programin e saj të shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik, bazohet në politikat themelore:

- Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë së Shkodrës me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.
- Gjithëpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskrimini për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.
- Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me insitucionet rajonale në varësi të pushtetit qendror, me bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.
- Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi I kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.
- Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve tjera shëndetësore në bashkëpunim me insitucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

Në zbatim të këtyre politikave, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2016, ka filluar procesin e krijimit dhe vënies në funksion të qendrave komunitare “Për Familjen”; nga një në çdo lagje të qytetit dhe gjithashtu në njësitë administrative të Bashkisë së Shkodrës, me synim shtrirjen e shërbimit komunitar në territorin e bashkisë së Shkodrës.

Në secilën prej këtyre qendrave, ofrohen shërbime si: pritje, informim, orientim, këshillim psikologjik, këshillim juridik, referim dhe çdo shërbim tjetër specific, sipas nevojave të rastit.

---

Me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve për të gjitha kategoritë vulnerabël, Bashkia e Shkodrës ka ftuar organizatat partnere të shoqërisë civile për të bashkëpunuar në ofrimin e shërbimeve pranë këtyre qendrave dhe për të krijuar kështu së bashku një model të standartizuar të shërbimit komunitar. Për një bashkëpunim sa më institucional me organizatat partnere janë arritur marrëveshje bashkëpunimi, ku shprehen qartë rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve. Në këtë listë të gjatë bëjnë pjesë; UNDP, Save the Children, Terre des Hommes, Acli/Ipsia/, Gruaja te gruaja, Malteser, Papa Xhovani XXiii, Shpresë për Botën, Eorld Vision, Code, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Projekti Shpresa, Arsis, NIsma për Ndryshim Shoqëror, etj.

Për çdo marrëveshje bashkëpunimi janë të përcaktuara qartë, qëllimi, baza ligjore, roli dhe përgjegjësia e Bashkisë dhe e partnerëve, qëndrueshmëria, kohëzgjatja, vendi i zbatimit, etj.

Ne jemi të hapur dhe mirëpresim çdo organizatë me synim bashkëpunimin në realizimin e projekteve të cilat i drejtohen dhe nga të cilët përfitojnë grupe sociale në vështirësi social-ekonomike.

Bashkia e Shkodrës, në të gjitha takimet dhe tryezat konsultative me shoqërinë civile, fton organizatat për t'u bërë pjesë dhe për të bashkëpunuar pranë qendrave komunitare tashmë të krijuara dhe konsoliduara, pasi synimi kryesor i shërbimeve pranë qendrave komunitare është përmirësimi i cilësisë së jetesës, integrimi dhe fuqizimi i individëve e grupeve në nevojë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**